



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 20 Prot.

Tiranë, më datë 12.01.2022

VENDIM
Nr. 1, datë 11.01.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 11.01.2022:


VENDOSI:

1. Të miratojë në parim “Projekt restaurimi “Xhamia e Plumbit”, Shkodër”, monument kulture i kategorisë së I-rë, me aplikues dhe projektues të licencuar në ndërhyrje në pasuri kulturore Znj. Adelina Baballëku, zhvillues “Kadioglu Insaat Taahhut Kollektif Sirketi Ismet Kadioglu/Adem Kadioglu”;
2. Të miratojë projektin e restaurimit të Xhamisë së Plumbit, duke përfshirë dhe sistemin e digave;
3. Të miratojë kërkesën për ringritjen e minaresë së Xhamisë së Plumbit me kushtin që për këtë propozim, projekti të plotësohet me një studim të thelluar mbi të dhënat arkivore, arkitektonike e historike, projektin e detajuar të zbatimit, analizë statike e specifikime teknike për pjesën e minaresë;
4. Të mosmiratojë kërkesën për ndërtimin e strukturave “njësi shërbimi” në territorin e Xhamisë së Plumbit, për të cilin nga zhvilluesi duhet të merren masa për hartimin e një projekti të veçantë lidhur me ndërhyrjet në zonën mbrojtëse të pasurisë kulturore duke përfshirë trajtimin e peizazhit dhe sistemimin e territorit përreth Xhamisë së Plumbit, në sinergji me vlerat arkeologjike, historike dhe fetare të zonës;
5. Të miratojë vendosjen e tabelës së identifikimit të punimeve pas miratimit paraprak nga IKTK;
6. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, Ligji Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, punimet e restaurimit të

- zbatohen dhe mbikëqyren në mbështetje të nenit 72, pika 1 dhe 2; si dhe gjatë procesit të gërmimeve, punimet të mbikëqyren nga specialistët arkeologë të DRTK Shkodër;
7. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkruara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
 8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 9. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 10. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO



KRYETAR
Elva MARGARITI

